16. 11. 2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRAČANICA

Në bazë të nenit 43 dhe nenit 47 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 5 të Udhëzimit administrativ nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të komunës, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës thërret mbledhjen e rregullt dhe dërgon:

FTESË

I/e nderuar,

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e gjashtë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, e cila do të mbahet të enjten më datën 26.11.2026. Mbledhja do të fillojë në orën 11:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit, kati i parë nr. 2.11 në objektin e Komunës së Graçanicës në Graçanicë.

Të bashkëngjitur me ftesë gjeni rendin e ditës dhe materialin për këtë mbledhje. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e rregullt, e mbajtur më datën 30.10.2026.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për caktimin e normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2027, me propozimin e drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq (***Slaviša Ničić***).

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për formimin e Grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Graçanicës për vitin 2027, me propozimin e kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (***Milan Dimitrijević***).

4. Informata për ndarjen e subvencioneve në fushën e bujqësisë për vitin 2026, me propozimin e drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq (***Bogić Đurović***).

5. Pyetje dhe përgjigje nga mbledhja e pestë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës, e mbajtur më datën 30.10.2026.

6. Të ndryshme.

Kryesuesi i KK të Graçanicës

Milan Dimitrijević